



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:121577

Datë: 13.06.2019

Numri i dokumentit: 00357437

**P.nr.1519/17**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Refki Piraj, me bashkëpunëtorin profesional Shqipron Sedolli, në lëndën penale ndaj të akuzuarit O.B nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.1583-5/17 të dt.18.07.2017, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë. 12.06.2019, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari**

**O.B**, nga i ati N., e ëma S., e lindur I., i lindur me dt. ..., në Prizren, tani jeton në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, ka te mbaruar shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr personal: ....

### **ËSHTË FAJTOR**

Se me datën 07.06.2017, rreth orës 17:30 min, në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të disa problemeve të më hershme, për shkak se i dëmtuari A.R po ia ngacmonte vajzën, i akuzuari ditën kritike i afrohet të dëmtuarit fillimisht i drejtohet me fjalët “pse po ma ngacmon vajzën” e pastaj e godet duke i ra me kokë në pjesën e hundës, ashtu që të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara më përafërsisht si në akt ekspertimin mjeko – ligjor të Dr. V.H dhe Dr. F.D, me nr. Ref. ... të dt. 20.06.2017.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par 1.4 të KPK-së.**

Andaj gjykatë në kuptim të nenit 495 të Kodit të Procedurës penale jep këtë:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

**PRANOHET KËRKESA** e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.II.nr.1583-5/17 të dt.18.07.2017.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 4,41,43 par.1 nën par 1.3, nenit 46,73 dhe nenit 185 par.1 të KPK-së, dhe nenit 365 dhe 495 të KPP-së të akuzuarit O.B, i shqipton:

### **DENIMIN ME GJOBË**

Ashtu që gjykata të akuzuarit A.K ia cakton dënimin me gjobë në lartësinë prej 160 €(njëqind e gjashtëdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, konform nenit 46 te KPK-se gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoje në dënim me burgim, konform nenit 46 p.4 te KPK-se.

I dëmtuari A.R, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civilë.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.1583-5/17 të dt.18.07.2017 kundër të pandehurit O.B, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden ne shkresat e lëndës , gjyqtari ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 p.1 te KPPK-se, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPPK-së vendosi qe ta pranoje kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë raporti i policor nr.... i dt. 13.07.2017, procesverbali mbi intervistimin e te dyshuarit nr....-... i dt. 14.06.2017, dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i pandehuri e

ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 dhe 495 të KPPK-se, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,  
P.nr.1519/2017, me datë 12.06.2019**

***B. Profesional,  
Shqipron Sedolli***

**Gjyqtari,  
Refki Piraj**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në këtë gjykatë. Po qese i pandehuri nuk paraqet kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.

Numri i lëndës: 2019:121577  
Datë: 13.06.2019  
Numri i dokumentit: 00357437